



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministrisë të Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 204 / 2022
Datë: 02 / 06 2022

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8, (paragrafi 1, nënparagrafi 1.4) të Rregullores (QRK) - nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (30.03.2021) e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) - nr. 04/2021 (10.09.2021), dhe nenin 17, përkatësisht nenit 24/B (paragrafi 2 dhe 4) të Rregullores QRK-nr. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në përputhje me nenin 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ministria e Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Znj. Argjira Asllani, emërohet Udhëheqëse e Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. E emëruara nga pika 1 e këtij Vendimi ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me dispozitat përkatëse të Rregullores QRK-nr. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Mandati i të emëruarës në pikën 1 të këtij Vendimi fillon me datë 02.06.2022 dhe zgjatë deri 31.05.2024 , përkatësisht derisa të mos merret ndonjë vendim tjetër.
4. Të ardhurat personale të emëruarës nga pika 1 e këtij Vendimi do të paguhet si pagë primare në vlerë prej 600 (gjashtëqind) euro bruto në muaj.
5. Obligohet Divizioni për Burime Njerëzore dhe Divizioni për Buxhet dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Meqë pozita e Udhëheqësit të Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, ka mbetur e zbrazët, dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe përgjegjësi që dalin nga legjislacioni përkatës në fuqi i kësaj fushe, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi i'u dërgohet:

- Znj. Argjira Asllani;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm/MD;
- Divizionit për Burime Njerëzore/MD;
- Divizionit për Buxhet dhe Financa/MD;
- Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.